



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR

KORÇE

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë kërkon të punësojë një punonjës në administratë me detyrë sekretare pranë prokurorëve.

Kandidati duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- Të ketë përfunduar arsimin e lartë në degën juridik.
- Të njohë dhe të përdorë shumë mirë MS-Office –Word, Excel dhe Internetin.
- Të ketë, mundësisht, përvojë profesionale në sistemin e drejtësisë, ose të ketë kryer praktikë profesionale që lidhet me sistemin e drejtësisë.

Personat e interesuar duhet të paraqitin në sekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dokumentat e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim ku të jepen adresa dhe numri i kontaktit;
2. Fotokopjen e diplomës dhe të listes te notave, të të dy niveleve, bachelor dhe master, të noterizuara;
3. Fotokopjen e diplomës ose vërtetim notash të shkollës së mesme të noterizuar;
4. Nje CV ku të përshkruhet qartë eksperiencia e punës dhe dëshmi për të vërtetuar ekperiencën në punë;
5. Dëshmi të kulifikimeve pas universitare;
6. Dëshmi të njohurive në programet kompjuterike MSOffice- Word dhe Excel;
7. Një certifikatë personale ose fotokopje të kartës të identitetit;
8. Dëshmi për zotërimin e gjuhëve të huaja (nëse ka).

Per çdo sqarim mund të kontaktoni në numrin 0822 43366, ose vizitoni faqen e internetit www.pp.gov.al.

Pranimi i aplikimeve mbyllet në datën 04.07.2022.